



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

Referuar kërkesës për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit më datë 08.03.2026 nga Z. Irgen Sinanaj bëjmë me dije si vijon:

Z. Irgen Sinaj i është drejtuar platformës “Shqipëria që Duam” më datë 29.12.2025 me çështje nr. **925758** me anë të së cilës ankohet për refuzimin e trajtimit të kërkesës së tij nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pasi komunikimi është drejtuar me postë elektronike dhe jo me shkresë zyrtare.

Çështja pasi është shqyrtuar paraprakisht nga ana e koordinatorit të Bashkëqeverisjes, është deleguar për trajtim në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe prej saj më datë 20.01.2026 është kthyer përgjigje si vijon:

“Për të marrë një përgjigje zyrtare në lidhje me qëndrimin e Administratës Tatimore mbi çështjen në fjalë, ju lutemi të dorëzoni një shkresë zyrtare drejtuar Drejtorisë Teknike dhe Ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila mund të paraqitet fizikisht pranë sportelit të institucionit ose të dërgohet me postë në adresën zyrtare të DPT-së.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me kërkesë të tatimpaguesit dhe kur kjo konsiderohet e nevojshme, mund të japë vendime ose sqarime për qëndrimin zyrtar të administratës tatimore lidhur me rrethana konkrete të një tatimpaguesi, në përputhje me legjislacionin tatimor. Këto vendime dhe interpretime bazohen në analizën e situatës faktike dhe të dokumentacionit mbështetës, për të siguruar një trajtim fiskal të drejtë për tatimpaguesin dhe pa pasoja për buxhetin e shtetit.

Në këtë kuptim, çdo kërkesë për interpretim të një situatë specifike duhet të përmbajë një paraqitje të qartë të rrethanave, përshkrimin e transaksionit dhe palëve të përfshira, të shoqërohet me dokumentacionin përkatës justifikues, si dhe me referencat ligjore për të cilat ekzistojnë paqartësi.”

Në vijim të komunikimit të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Z. Irgen Sinanaj i është kthyer përgjigje nëpërmjet platformës “Shqipëria që Duam”.

Qytetari ka rihapur çështjen me komente, por duke mos shtuar të dhëna të reja për ritrajtim.

Referuar nenit 38 “Verifikimi paraprak përpara fillimit të shqyrtimit të ankesës”, të Ligjit 107/2021”Për Bashkëqeverisjen”:

- 1) Pas regjistrimit të ankesës dhe përpara fillimit të shqyrtimit të saj, Agjencia kryen verifikimet:
 - dh) nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër, ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;

Për sa më lart, qytetari ka marrë përgjigje shteruese nga institucioni dhe çështja konsiderohet e mbyllur.